



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KUÇOVË

Nr. 457 Prot.

Kuçovë, më 06.02. 2024

V E N D I M

Nr. 07, datë 30.01.2024

PËR
MIRATIMIN E BASHKËFINANCIMIT PËR PROJEKTIN E “ PËRMIRËSIMIT TË
BANESAVE EKZISTUESE PËR KOMUNITETET E VARFËRA DHE TË
PAFAVORIZUARA” PËR VITIN 2024.

Këshilli Bashkiak Kuçovë në mbledhjen e tij të datës 30.01.2024, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbeshtetur në pikën 2, të nenit 24, germa “k” e nenit 54 , të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 11 pika 1, germa b të ligjit nr.22 /2018 “ Për strehimin social”, dhe bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 454 datë 03.07.2019 “ Për kriteret dhe procedurat e përfitimit e të dhënies së granteve konkurruese për përmirësimin e kushteve të objekteve dhe banesave ekzistuese, referuar shkresës ardhur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë me nr. 741 Prot. datë 12.01.2024, protokolluar pranë institucionit tonë me nr.209 Prot. datë 19.01.2024 me lëndë: Mbi fondet për programet e strehimit për vitin 2024, nepërmjet së cilës janë publikuar afatet dhe termat e referencës për aplikime për fondet e investimeve.

V E N D O S I

1. Të miratojë kuotën e bashkëfincimit të shprehur në përqindje **30%** dhe në **9 763 930 lekë** për projektin Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara Kuçovë 2024.

A: Lagjia nr.1, Blloku “ T. Skendo”, Kuçovë, Shqipëri. www.bashkiakucove.gov.al



2. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Kuçovë , Drejtoria e Financës dhe Buxhetit dhe Drejtoria e Planifikimit Zhvillimit të Territorit dhe Koordinimit – Zhvillimit Strategjik
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të ligjit nr.139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar.

Ky vendim u miratua me 22 vota pro, — vota kundër, — vota abstenim.

KRYETARI I KESHILLIT BASHKIAK

Aleksandër Ziu

